



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

KPPP.nr.1641/22

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtari Gent Bekeri, në çështjen përmbarimore të kreditorit “Banka Ekonomike” Sh.A., me seli në Prishtinë, rruga “Migjeni” nr.1, kundër debitorëve 1.) N.SH “ELF”, me seli në Suharekë, rruga “Brigada 123”, 2.) E.K. nga fshati - Suharekë, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit, të ushtruar kundër Urdhrit Përmbarimor E.nr.160/07 të datës 27.04.2007 lidhja P.nr.413/21, të lejuar nga Gjykata Komunale në Suharekë, jashtë seancës me datën 18.08.2023, merr këtë:

A K T V E N D I M

I. PRANOHET si i bazuar prapësimi i debitorit N.SH “ELF” nga Suhareka, ANULOHET Urdhri për lejimin e përmbarimit E.nr.160/10 i datës 27.04.2007 lidhja P.nr.413/21 i lejuar nga Gjykata Komunale në Suharek dhe PËRFUNDOHET në tërësi përmbarimi në këtë çështje përmbarimore.

A r s y e t i m

Gjykata Komunale në Suharekë, duke vepruar sipas propozimit për përmbarim të kreditorit, në bazë të dokumentit Marrëveshja kreditore nr. 445 datës 25.10.2005, marrëveshje për kreditor suazor nr. 445/1 datës 25.10.2005, marrëveshje hipotekare nr. 446 e datës 25.10.2005 e vërtetuar në Gjykatën me numër VR.nr. 3853/05 datës 07.11.2005 në shumë 19,458.00 € me kamatë të interesit ndëshkues prej 0.05% duke filluar nga data 21.04.2007 deri në ditën e pagimit, si dhe të gjitha shpenzimet e procedurës përmbarimore. Nëse debitori nuk e përmbush obligimin në afatin e përcaktuar atëherë lejohet realizimin i kërkesës nëpërmjet shitjes, me ankande publik të pasurisë së paluajtshme të të E.K.t të vënë si hipotekë me marrëveshje hipotekare e cila është vërtetuar në Gjykatën Komunale në Suharekë, ndërsa me datën 19.10.2020 ka është precizuar propozimi në titull ekzekutiv dhe ate sipas - Aktgjykimit të Gjykatës Komunale në Suharekë C.nr.156/2009 të datës 22.03.2010 shumën prej 16.284,44 € ka nxjerr Aktvendim Ekz.nr. 160/04

të datës 17.04.2007 , me të cilin është detyruar debitori, që t'ia paguajnë kreditorit shumën prej 19,458.00 €.

Përmbauesi privat me konkluzionin P.nr.413/21 të datës 16.11.2021, çështja përmbaimore E.nr.576/10 sipas zgjedhjes së kreditorit i është dërguar Përmbauesit Privat Saranda Kuçi, me seli Prizren për vazhdimin e procedurës së përmbaimit. Përmbauesi me të njëjtin konkluzion, i ka njoftuar palët se procedura përmbaimore e filluar nga Gjykata Komunale në Suharekë vazhdohet nga përmbauesi.

Debitori në prapësimin e paraqitur brenda afatit ligjor ka deklaruar se dokumenti mbi të cilin është marr vendimi është një aktgjykim i vitit 2010 të cilin nuk e ka pranuar asnjëherë dhe si i tillë nuk mund të konsiderohet titull ekzekutiv pasi që nuk ka mundur të paraqes ankese kundër aktgjykimit. Andaj i propozon Gjykatës ta aprovoj prapësimin si të bazuar, ta refuzoj në tërësi urdhrin si dhe shpenzimet e procedurës përmbaimore t'i bartë kreditori.

Kreditori në përgjigjen në prapësim nder të tjera ka deklaruar se pretendimet e debitorit rreth mos informimit nuk qëndrojnë pasi që debitori ka pasur përfaqësues të përkohshëm – avokat. Tutje thekson se Aktgjykimi C.nr.156/2009 është titull ekzekutiv sipas LPP-së dhe se urdhri është marrë duke u bazuar në dokumentin përmbaues. Duke u bazuar në të lartcekurat i propozon Gjykatës ta refuzoj prapësimin si të pabazuar, ta lë në fuqi urdhrin si dhe debitorët t'i mbulojnë shpenzimet e procedurës përmbaimore.

Gjykata pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim, kundërshtimeve të kreditorit të paraqitura me përgjigje në parapësim dhe pas shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës dhe duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligji Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbaimore, (tutje LPP), gjeti se prapësimi i debitorit është i bazuar dhe se urdhri përmbaimit duhet të anulohet për shkaqet si në vijim:

Në rastin konkret rezulton se propozimi i kreditorit është ushtruar duke u bazuar në Aktgjykimin e Gjykatës Komunale në Suharekë C.nr.156/2009 të datës 22.03.2010, me të cilin debitori është detyruar që kreditori t'ia paguaj shumën në lartësi prej 15,218.44 € me kamatën vjetore 14% gjerë me datën 13.03.2010.

Gjykata gjeti se dokumenti mbi të cilin është propozuar lejimi i përmbaimit, nuk përbën bazën juridike për caktimin e përmbaimit pasi që nuk paraqet titull ekzekutiv sipas nenit 21 i cili

përcakton “Organi përmbarues e cakton, përkatësisht e zbaton përmbarimin vetëm në bazë të dokumentit përmbarues (titulus executionis) dhe dokumentit të besueshëm, po qe se me këtë ligj nuk është parashikuar diçka tjetër” dhe nenit 36 par. 1 i cili përcakton se: “Së bashku me propozimin për përmbarim, organit përmbarues i dorëzohet edhe dokumenti përmbarues, origjinal apo kopje e vërtetuar, me klauzolën e përmbarueshmërisë për përmbarueshmëri”, të LPP-së.

Gjykata vlerëson se në rastin konkret dokumenti mbi bazën e të cilës është lejuar përmbarimi të paraqitur në propozim Marrëveshja kreditore nr. 445 datës 25.10.2005, marrëveshje për kreditor suazor nr. 445/1 datës 25.10.2005, marrëveshje hipotekare nr. 446 e datës 25.10.2005 e vërtetuar në Gjykatën me numër VR.nr. 3853/05 datës 07.11.2005 të njëjtat nuk i janë bashkangjitur propozimit për përmbarim, ndërsa precizimi i përmbarimit në të cilën është vazhduar procedura përmbarimore sipas Aktgjykimit të Gjykatës Komunale në Suharekë C.nr.156/2009 të datës 22.03.2010, mbi të cilin mbështetet plotësimi i propozimi për përmbarim, e mbi bazën e të cilit përmbaruesi privat ka vazhduar përmbarimin, nuk ka tipare të përmbarueshmërisë, përkatësisht nuk i plotëson kushtet për përmbarim të përcaktuara me nenin 36 par.1 të LPP-së, pasi që i njëjti nuk është dorëzuar në origjinal apo në kopje të vërtetuar.

Andaj duke u bazuar në të lartcekurat gjykata vlerëson se dokumenti përmbarimor në bazë të cilit është lëshuar urdhri duhet të anulohet dhe procedura përmbarimore të përfundohet në tërësi, duke u bazuar në nenin 73 par.1 dhe par. 3 të LPP-së, nenin 12 par. 2 të Ligjit Nr.05/L-118 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr.04/L-139 për Procedurën Përmbarimore dhe nenin 13 par.1 nën par 1.2 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr.1641/22 datë 18.08.2023

Gjyqtari

Gent Bekeri

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimit të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së parë të kësaj Gjykate.